



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 64 datë 06.09.2018**

**PËR**

**MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE  
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR  
SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME FIER**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura" dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura", pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Fier është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 2, datë 22.01.2014, "Për licencimin e Ujësjetllës Kanalizime Fier" me afat vlefshmërie deri në datën 21.01.2018.
- Shoqëria UK Fier me shkresë nr. 122 prot datë 31.01.2018 ka aplikuar për rinovimin e licencës si dhe për zgjerimin e zonës së shërbimit në kuadër të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale. Në dokumentacionin e dërguar pranë ERRU mungon dokumenti "Akt Miratimi i Lejes Higjeno-Sanitare", dokument i cili ende nuk është paraqitur nga shoqëria.
- Komisioni Kombëtar Rregullator në mbledhjen e mëparshme ka gjykuar që shoqëria UK Fier duhet të plotësojë dokumentin e mësipërm me qëllim vijimin e procedurës për licencimin e saj.

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Fier me shkresë nr. 752 prot. datë 23.10.2017 ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, për zonën e re të shërbimit që ka marrë në administrim.
- Dosja e aplikimit për miratimin e tarifave të reja të propozuara nga shoqëria UK Fier është paraqitur e plotë sipas standardit të kërkuar nga ERRU për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.
- Për shqyrtimin e analizës si dhe vendimmarrjen për tarifave të propozuara nga UK Fier, pengesë mbetet mungesa e rinovimit të licencës së shoqërisë UK Fier edhe për zonën e re të shërbimit.
- Në mbledhjen e datës 06.09.2018 Komisioni Kombëtar Rregullator analizoi dhe një herë situatën e aplikimeve për ndryshimin e tarifave të shoqërive UK. Për shoqërinë UK Fier gjykoi se ka kaluar një periudhë e gjatë që nga momenti i aplikimit ku shoqëria UK Fier nuk është treguar korrekte me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar me qëllim vijimin e procedurës nga ERRU për pajisjen me licencë për shërbimet UK e cila ka frenuar procedurën e mëtejshme të aplikimit për miratimin e tarifave.

Për sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator

### **VENDOSI:**

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për zonat e reja.
2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Fier detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me dokumentacionin dhe të dhënat e plota pasi Licenca për ushtrimin e aktivitetit të jetë miratuar nga KKRR.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Ndriçim Shani**